



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(PROVIM ME ZGJEDHJE)

**LËNDA:
GJEOGRAFI E THELLUAR**

Koordinatorë: Evis Mastori

Viti shkollor: 2017 -2018

1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues për lëndën “Gjeografi e thelluar” për gjimnazin përfshin njohuritë dhe shprehitë më të rëndësishme të programit bërthamë të lëndëve Shkenca e Tokës (klasa e 10-të), Gjeografia rajonale e botës (klasa e 11-të), Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare (klasa e 12-të) si dhe njohuritë dhe shprehitë më të rëndësishme të programit të gjeografisë së thelluar “Gjeografia e problemeve globale”.

- Programi, orienton **nxënësit** për njohuritë dhe shprehitë themelore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Gjeografi e thelluar”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e kësaj lënde që do të përgatisin maurantët për provimin e lëndës me zgjedhje “Gjeografi e thelluar”.
- Programi përbën një dokument zyrtar, që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët** e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Gjeografisë së thelluar”, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara. Kujdes i veçantë të tregohet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t'i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e testeve të Maturës Shtetërore.

Testi për lëndën “Gjeografi e thelluar” do të ndërtohet në mënyrë të tillë që në të të jenë të përfshira të tria nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Nxënësit duhet të kenë parasysh se fusha, e cila ka numrin më të madh të orëve (objektivave) në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

Në përgatitjen për përmbushjen e objektivave të këtij programi do të përdoren tekstet mësimore të miratuara nga MASR, të kësaj lënde. Mund të përdoren edhe tekste ndihmëse apo materiale shtesë, që sigurojnë arritjen e objektivave të programit orientues.

2. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT SIPAS LINJAVE

SHKENCA E TOKËS – Klasa X

Linja: Sistemi diellor

Linja *Sistemi diellor* përfshin njohuritë dhe konceptet bazë mbi origjinën, përbërjen dhe lëvizjen e trupave qiellorë në hapësirë. Shpjegimi i tërheqjes gravitacionale të trupave në sistemin diellor, interpretimi i formimit të ditë-natës, stinëve, baticave dhe zbaticave, fazave të Hënës dhe eklipseve përmes studimit të marrëdhënieve Tokë-Hënë-Diell, karakteristikat e Diellit dhe roli i tij për jetën në Tokë, karakteristikat e planetëve dhe objekteve të tjera brenda këtij sistemi, si dhe revolucionarizimi i studimit të Universit përmes zhvillimeve teknologjike, janë piketat kryesore të përmbajtjes së kësaj linje.

Bloku tematik	Objektivat
Sistemi diellor dhe Toka si planet	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë përmasat e Diellit, strukturën, karakteristikat kryesore të secilës shtresë e dukuritë diellore;- të përshkruajë formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre;- të identifikojë provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj;- të shpjegojë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth boshtit;- të analizojë lëvizjen e Tokës rreth Diellit dhe pasojat e kësaj lëvizje;- të shpjegojë sesi fazat e Hënës varen nga pozicioni relativ i Diellit, Hënës dhe Tokës;- të shpjegojë pse dhe si ndodhin eklipset, duke diferencuar eklipset e Hënës nga ato të Diellit;- të dallojë planetët e brendshëm, të jashtëm, e satelitët e tyre, duke përshkruar disa ndër karakteristikat kryesore të tyre;- të përshkruajë kometat, asteroidët, meteorët dhe veçoritë e tyre.

Linja: Hartografia

Linja *Hartografia* studion mënyrën e projektimit të Tokës në hartë e në glob. Përveç njohurive që nxënësit marrin mbi globin, hartat, llojet e tyre, elementet e hartës, projektionet hartografike, rrjetin gjeografik e koordinatat gjeografike, kjo linjë synon kryesisht aftësimin praktik të nxënësve për punën me hartën, përcaktimin e vendndodhjes së pikave të ndryshme në hartë, përcaktimin e largësive reale nisur nga shkalla e hartës, apo përcaktimin e kohës zonale e lokale.

Bloku tematik	Objektivat
Paraqitja e Tokës në hartë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë ndërtimin e rrjetit gjeografik (sistemin e meridianëve dhe paraleleve, gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike); - të interpretojë me ndihmën e hartës brezat e kohës; - të përcaktojë në hartë e në glob vendndodhjen gjeografike të një vendi përmes koordinatave gjeografike; - të llogarisë kohën lokale e zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike; - të analizojë elementet matematikore (rrjeti hartografik, shkalla e hartës) dhe gjeografike të hartës dhe përdorimin e tyre; - të klasifikojë hartat sipas përmbajtjes, shkallës, përdorimit, mbi bazën e veçorive dalluese të tyre; - të ndërtojë dhe të interpretojë profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë; - të përcaktojë largësinë në terren nëpërmjet shkallës së hartës.

Linja: Gjeosistemet

Toka përbëhet nga katër sisteme të mëdha: atmosfera, hidrosfera, litosfera dhe biosfera. Përmes linjës *Gjeosistemet* synohet që nxënësi/i,-ja të kuptojë dukuritë dhe proceset natyrore që kanë ndodhur dhe ndodhin në këto sisteme, ndërveprimin midis tyre dhe rrjedhojat e këtij ndërveprimi për Tokën. Kjo përmbajtje fokusohet në shpjegimin shkencor të lidhjeve dhe të marrëdhënieve shkak-pasojë të proceseve dhe dukurive më shumë sesa në përshkrimin e tyre. Linja *Gjeosistemet* përbëhet nga katër blloqe tematike: atmosfera, hidrosfera, litosfera dhe historia e Tokës, biosfera.

Bloku tematik	Objektivat
Atmosfera	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë përbërjen e atmosferës, ndërtimin strukturor, duke dhënë karakteristikat më kryesore të shtresave të saj; - të interpretojë rëndësinë e shtresës së ozonit për jetën në tokë dhe pasojat e ndikimit të veprimtarisë njerëzore në të; - të analizojë llojet e rrezatimit: të drejtpërdrejta, të shpërndara, të përgjithshme dhe tokësor, përmes dukurisë së përcjellshmërisë dhe konveksionit; - të analizojë ndryshimin e temperaturës në kohë (ditore e vjetore) dhe në hapësirë (vertikal e horizontal) dhe faktorët që ndikojnë në të; - të llogarisë temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit; - të formulojë konceptet: lagështirë e ajrit, lagështirë absolute dhe relative; - të përshkruajë procesin e kondensimit të avujve të ujit dhe formimin e vesës, mjegullës, brymës e reve; - të shpjegojë kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve; - të ndërtojë dhe interpretojë grafikët e shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve; - të analizojë ndryshimet e trysnisë atmosferike në kohë e në hapësirë; - të analizojë faktorët kryesorë që përcaktojnë elementet e erës (drejtimi dhe shpejtësia); - të shpjegojë erërat e qarkullimit të përgjithshëm dhe formimin e tyre; - të formulojë konceptet masë ajrore dhe front; - të përshkruajë erërat lokale; - të analizojë ciklonin dhe anticiklonin; - të shpjegojë ndikimin e regjimit ciklonik në gjerësitë mesatare;

	<ul style="list-style-type: none"> - të formulojë konceptet mot dhe klimë; - të analizojë faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; - të klasifikojë zonat klimatike nga ekuatori në pole;
Hidrosfera	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë hidrosferën dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera (litosferën, atmosferën, biosferën); - të interpretojë qarkullimin e ujit në natyrë; - të identifikojë vetitë fizike e kimike të ujit të oqeaneve e deteve; - të përcaktojë format e lëvizjeve të ujërave oqeanike; - të shpjegojë elementet e valës detare dhe mënyrën e formimit të valëve detare; - të analizojë shkaqet e formimit të baticave dhe zbaticave dhe pasojat e tyre; - të vlerësojë rëndësinë e baticave e zbaticave dhe shfrytëzimin e energjisë së tyre nga njeriu; - të analizojë lëvizjen e rrymave oqeanike, faktorët që ndikojnë në formimin e tyre dhe llojet kryesore të këtyre rrymave; - të vlerësojë rëndësinë e rrymave oqeanike për klimën në Tokë; - të përshkruajë karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; - të analizojë liqenet sipas origjinës së formimit të tyre, shoqëruar me shembuj konkretë nga bota e vendi ynë; - të përshkruajë evolucionin e liqeneve në kënetë dhe faktorët që ndikojnë në këtë shndërrim; - të dallojë llojet e ujërave nëntokësore dhe mënyrën e formimit të tyre; - të përshkruajë llojet e ndryshme të burimeve; - të analizojë kushtet e formimit të borës së përhershme dhe akullnajave; - të diferencojë akullnajat malore nga ato kontinentale;
Litosfera dhe historia e Tokës	<ul style="list-style-type: none"> - të diferencojë shtresat e Tokës, duke dhënë veçoritë kryesore të secilës prej tyre; - të shpjegojë ndryshimin e temperaturës, trysnisë dhe dendësisë

	<p>në brendësi të Tokës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë mënyrën e formimit të mineraleve dhe vetitë fizike të tyre (fortësia, ngjyra, shkëlqimi, thyerja); - të përshkruajë llojet kryesore të shkëmbinjve; - të interpretojë ciklin e shkëmbit dhe proceset që ndodhin në të; - të analizojë krijimin e magmës dhe mënyrën e formimit të shkëmbinjve magmatikë; - të diferencojë shkëmbinjte magmatikë sipas përbërjes së magmës; - të shpjegojë kushtet e formimit të shkëmbinjve sedimentarë dhe llojet e tyre; - të shpjegojë mënyrën e formimit të shkëmbinjve metamorfikë dhe llojet e tyre; - të përshkruajë mënyrat e formimit të fosileve; - të përshkruajë ndarjen e kohës gjeologjike në era dhe periudha;
Biosfera	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë faktorët që ndikojnë në botën bimore e shtazore.

Linja: Dinamika e Tokës

Relievi i Tokës, tiparet e saj janë pasojë e veprimtarisë së forcave të brendshme dhe të jashtme, të cilat në mënyrë të vazhdueshme modelojnë sipërfaqen e Tokës. Forma e sotme e relievit të Tokës është rezultante e bashkëveprimit të forcave të brendshme dhe të jashtme. Në historinë e zhvillimit të Tokës, secila prej këtyre forcave ka ndikuar dhe ndikon në përmasa të ndryshme, gjë që ka çuar dhe në krijimin e formave të ndryshme në reliev. Format e krijuara nga forcat e brendshme, në mënyrë të vazhdueshme modelohen nga veprimi i forcave të jashtme, duke krijuar larmi në formë, ndërtim e përmasa.

Linja *Dinamika e Tokës* përbëhet nga dy blloqe tematike: Ndryshimet në Tokë nën ndikimin e forcave të brendshme, dhe ndryshimet në Tokë nën ndikimin e forcave të jashtme.

Bloku tematik	Objektivat
Ndryshimet në Tokë nën ndikimin e forcave të brendshme	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë konceptin pllaka tektonike dhe shpërndarjen e tyre; - të analizojë mënyrën e lëvizjes së tyre;

	<ul style="list-style-type: none"> - të listojë argumentet që mbështetin tektonikën e pllakave dhe kundërshtitë; - të analizojë llojet e kufijve të pllakave tektonike; - të shpjegojë krijimin e topografisë së sipërfaqes së tokës dhe të dyshemesë së oqeanit përmes tektonikës së pllakave; - të përshkruajë llojet e lëvizjeve luhatëse; - të analizojë shkaqet e lëvizjeve luhatëse dhe pasojat e tyre; - të identifikojë dëshmi të lëvizjeve luhatëse pozitive dhe negative; - të analizojë lëvizjet rrudhosëse e shkëputëse dhe shkaqet e tyre; - të evidentojë format e relievit që krijohen si pasojë e lëvizjeve rrudhosëse e shkëputëse; - të shpjegojë dukurinë e formimit të tërmeteve; - të përshkruajë tipat e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës; - të tregojë instrumentet që përdoren për matjen e tërmeteve (madhësinë e matjes); - të identifikojë pasojat e tërmeteve; - të përcaktojë në hartë shpërndarjen gjeografike të tërmeteve; - të përshkruajë vullkanin, pjesët përbërëse të tij, produktet vullkanike; - të analizojë shkaqet e shpërthimit të vullkaneve; - të diferencojë llojet e shpërthimeve dhe format vullkanike që krijojnë; - të vlerësojë rrjedhojat e vullkaneve; - të përcaktojë në hartë shpërndarjen gjeografike të vullkaneve;
<p>Ndryshimet në Tokë nën ndikimin e forcave të jashtme</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojë konceptin tjetërsim fizik, kimik e biologjik; - të analizojë kushtet në të cilat ndodh secili prej tjetërsimeve; - të argumentojë ndikimin e tjetërsimit në dinamikën e sipërfaqes së Tokës; - të përshkruajë procesin e formimit të dherave; - të analizojë faktorët që ndikojnë në formimin e dherave; - të dallojë shtresat e dherave dhe veçoritë e tyre; - të analizojë kushtet në të cilat ndodhin rrëshqitjet, rrëzimet dhe

	<p>shembjet;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë ndikimin e veprimtarisë së gravitetit në relievin e vendit tonë (rrëshqitjet, rrëzimet, shembjet); - të analizojë veprimtarinë gërryese, transportuese e depozituese të erës dhe format karakteristike të relievit, që krijohen si pasojë e saj; - të analizojë veprimtarinë gërryese, transportuese e depozituese të ujërave rrjedhëse (lumenj, përrenj) dhe format e krijuara prej saj; - të përkufizojë konceptin karst; - të analizojë kushtet në të cilat zhvillohet procesi i karstit; - të përshkruajë format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike; - të analizojë veprimtarinë gërryese, transportuese e depozituese të akullnajave dhe format e krijuara prej saj; - të analizojë veprimtarinë gërryese, transportuese e depozituese në brigjet detare; - të përshkruajë format e krijuara nga veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese e deteve; - të klasifikojë tipat e bregdeteve (i ulët, i lartë) dhe karakteristikat e tyre.
--	--

Linja: Mjedisi dhe shoqëria

Studimi i kësaj linje u mundëson nxënësve të vlerësojnë që njeriu ndërvepron me mjedisin, për më tepër, që njohja e shkencës së Tokës është thelbësore në planifikimin e ndërtimeve, rrugëve, porteve, kanaleve etj. Konteksti mjedisor i kësaj linje i vjen në ndihmë nxënësve për të kontribuar në debate dhe vendime si qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm.

Blloku tematik	Objektivat
Mjedisi dhe shoqëria	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë konceptin për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm; - të listojë format kryesore të ndotjes; - të analizojë shkaqet kryesore të ndotjes së tokës;

	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pasojat e ndotjes së tokës; - të analizojë ndotjen e ajrit duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në të; - të përshkruajë smogun, shiun acid dhe pasojat e tyre; - të vlerësojë rëndësinë e cilësisë së ajrit për organizmat e gjallë dhe shëndetin e njerëzve; - të analizojë ndotjen e ajrit, duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në të; - të analizojë ndotjen e ujit, duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në të. - të përshkruajë disa ndër problemet më të mëdha globale me burimet ujore, si: thatësira, rritja e popullsisë, ujitja.
--	---

GJEOGRAFIA RAJONALE E BOTËS – Klasa XI

Linja: Rajonet

Kjo linjë prezanton një panoramë të përgjithshme të rajoneve më të mëdha të botës, parë nga perspektiva e problemeve dhe integritit. Nëpërmjet studimit rajonal, nxënësit në mënyrë kritike analizojnë e vlerësojnë proceset dhe dukuritë e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre. Në këtë mënyrë formohen bazat e domosdoshme gjeografike për të ndërtuar këndvështrimet mbi ngjarjet aktuale rajonale e globale dhe proceset integruese në nivel vendor, rajonal e global.

Linja “Rajonet” përbëhet nga blloqet tematike:

- Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve
- Europa - karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale
- Amerika e Veriut
- Amerika Qendrore
- Amerika e Jugut
- Afrika Nënsahariane
- Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore
- Azia Jugore
- Azia Lindore
- Azia Juglindore
- Australia, Oqeania

Bloku tematik	Objektivat
Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë termat bazë në gjeografi, si: pozicioni, rajoni, marrëdhëniet njeri-mjedis dhe proceset hapësinore; - të identifikojë kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe të klasifikimit të rajoneve të ndryshme sipas llojeve apo tipeve të tyre; - të analizojë kuptimin e koncepteve taksonomike të niveleve të ndryshme si makro-rajon, rajon, etj; - të identifikojë tipat dhe llojet kryesore të rajoneve të botës; - të analizojë e vlerësojë proceset e sotme integruese dhe marrëdhëniet në nivele të ndryshme: lokale, rajonale e globale; - të vlerësojë tendencat e sotme globalizuese dhe problemet në këtë proces; - të argumentojë qëndrimet pro dhe kundra ndaj këtyre proceseve; - të vlerësojë nivelet e problemet e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre; - të vlerësojë problemet e sotme globale dhe veçoritë rajonale të tyre; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve kulturore botërore (qeverisja, etniciteti, gjuha, sistemi ekonomik - të analizojë rajonet kulturore të botës së sotme përmes shembujve; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve ekonomike përmes shembujve tip; - të vlerësojë përmes një ese-je raportin që ekziston midis globalizimit dhe veçorive kulturore të vendeve apo rajoneve të ndryshme gjeografike sot në botë; - të përshkruajë rolin dhe rëndësinë që luajnë në rajone të ndryshme organizmat ndërkombëtarë (p.sh., OKB, UNICEF etj.);

	<ul style="list-style-type: none"> - të plotësojë hartat skicë (fiziko-gjeografike) të makrorajoneve të botës.
RAJONET	
Evropa - Karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë rolin e pozitës gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme gjeografike të Evropës; - të analizojë veçoritë specifike rajonale natyrore e humane të Evropës; - të vlerësojë zhvillimin historiko-territorial rajonal të Evropës; - të evidentojë rajonet kryesore bazë të Evropës (Evropa Perëndimore, Qendrore, Veriore, Ishullore, Mesdhetare, Lindore); - të interpretojë historikun dhe karakteristikat e formimit, zhvillimit e zgjerimit të BE-së; - të vlerësojë makrorajonin rus, proceset dhe problemet e sotme të perspektivës rajonale e globale; - të identifikojë disa ndër problemet e sotme rajonale të Evropës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre;
Amerika e Veriut	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë karakteristikat dhe tiparet e përgjithshme natyrore e humane të Amerikës së Veriut; - të analizojë tipat dhe llojet e ndryshme të rajoneve të SHBA-së, si dhe modelet e tyre të zhvillimit, duke evidentuar modelin ekonomik të zhvillimit të SHBA-së; - të analizojë problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të kontinentit veriamerikan, si dhe perspektivën e tyre;
Amerika Qendrore	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike të rajonit të Amerikës Qendrore; - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Qendrore, duke evidentuar gërshetimin e kulturave; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni;
Amerika e Jugut	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë kushtet natyrore të rajonit të Amerikës së Jugut; - të përshkruajë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit

	<p>të Amerikës Jugore, duke evidentuar diferencimin hapësinor të kulturave vendase dhe evropiane;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni;
Afrika Nën-Sahariane	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë tiparet fiziko-gjeografike të Afrikës Nën-Sahariane, duke evidentuar tipizimin e botës bimë dhe shtazore; - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Afrikës Nën-Sahariane; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni;
Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, si dhe kushtet natyrore; - të vlerësojë kompleksitetin gjeografik, kulturor, politik të Lindjes së Mesme, duke u ndalur në sfidën e Islamit; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, bazën e resurseve të naftës dhe rolin e saj në zhvillimin e rajonit;
Azia Jugore	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë kushtet natyrore të këtij rajoni, me fokus praninë e lartësive më të mëdha në botë; - të identifikojë veçoritë e popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Jugore;
Azia Lindore	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të rajonit të Azisë Lindore; - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Lindore; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni (modeli kinez dhe japonez);
Azia Juglindore	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë tiparet fiziko-gjeografike të rajonit të Azisë Juglindore; - të identifikojë veçoritë kryesore të popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore, me fokus modelin e zhvillimit ekonomik të një prej shteteve të ashtuquajtur "tigrat e Azisë";

Australia, Oqeania	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë, si dhe kushtet natyrore; - të identifikojë veçoritë e popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë.
---------------------------	--

GJEOGRAFIA E SHQIPËRISË DHE E TREVAVE TË TJERA SHQIPTARE – Klasa XII

Linja: Vendndodhja gjeografike

Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë një tablo të qartë mbi hapësirën që zënë trevat shqiptare në Ballkan dhe në Evropë. Linja synon të formojë te nxënësit koncepte të qarta mbi rëndësinë e pozitës së trevave shqiptare në aspektin natyror dhe në atë gjeopolitik. Nxënësit aftësohen të bëjnë analiza krahasuese të ndryshimeve të hartës politike të trevave shqiptare.

Blloku tematik	Objektivat
Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë shtrirjen, përbërjen e trevave shqiptare (Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, në Maqedoni, në Greqi dhe në Malin e Zi); - të analizojë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, Mesdhe, Evropë dhe më gjerë; - të vlerësojë rolin e kësaj pozite në veçoritë natyrore gjeografike, në popullimin e trevave dhe zhvillimin ekonomik, dhe pasojat e kësaj pozite në copëtimin e trevave shqiptare; - të analizojë ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe në hapësirë harta politike e trevave shqiptare.

Linja: Sistemet fizike

Peizazhet e larmishme që ofrojnë trevat shqiptare, ndërtimi gjeologjik, relievi dhe faktorët që ndikojnë në formimin e tij, pasuritë klimatike dhe hidrografike, bota e gjallë e tyre etj., krijojnë atë shumëllojshmëri mjaft të spikatur të mjediseve të trevave shqiptare. Nxënësit propozojnë rrugëzgjdhje për problemet e shkallës së lartë të degradimit dhe shkretimit të peizazheve, një ndër problemet më shqetësuese të mjedisit sot në këto treva.

Bloku tematik	Objektivat
Shumëllojshmëria e mjediseve dhe peizazheve të trevave shqiptare	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë etapat e formimit të truallit të trevave shqiptare, përbërjen litologjike dhe strukturore të tij dhe rolin e tyre në pasuritë e shumta minerare; - të evidentojë faktorët e formimit të relievit, sistemet kryesore të tij; - të evidentojë tiparet kryesore të klimës së trevave shqiptare; - të vlerësojë rolin dhe ndikimin e klimës në dukuritë e tjera natyrore, në shpërndarjen e popullsisë dhe aktivitetet e saj; - të analizojë larminë dhe pasurinë e madhe hidrografike të trevave shqiptare; - të analizojë kushtet dhe faktorët e formimit të tokave të larmishme të trevave shqiptare; - të analizojë faktorët e kushtet që kanë ndikuar në shkallën e lartë të degradimit dhe shkretimit të tokave, si dhe pasojat e tyre; - të analizojë faktorët që kanë përcaktuar larminë dhe pasurinë e madhe bimore dhe shtazore të trevave shqiptare.

Linja: Sistemet humane

Nxënës/i,-ja analizon gjendjen dhe ndikimin e faktorëve ekonomikë, socialë, politikë e kulturorë mbi fizionominë dhe dinamikën e popullsisë shqiptare, ekonomisë e sektorëve të saj si dhe ndikimin e organizimit të sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare në zhvillimin e integrimin rajonal dhe evropian të tyre.

Kjo linjë përbëhet nga blloqet tematike:

- Organizimi administrativ i trevave shqiptare.
- Popullsia dhe vendbanimet.
- Ekonomia e trevave shqiptare.

Bloku tematik	Objektivat
Organizimi administrativ i	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë ndryshimet në organizimet administrativo-

trevave shqiptare	<p>tokësore në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës dhe në trevat e tjera shqiptare;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë organizimin e sotëm politiko-administrativ të trevave shqiptare, masat që janë marrë për integrimin rajonal dhe evropian të tyre; - të përshkruajë disa ndër problemet më të mëdha globale me burimet ujore, si: thatësira, rritja e popullsisë, ujitja;
Popullsia dhe vendbanimet	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë kushtet dhe faktorët që kanë ndikuar në popullimin e trevave shqiptare; - të përshkruajë elementet (karakteristikat) kryesore demografike të popullsisë së trevave shqiptare (numri i popullsisë, shtimi natyror, struktura e popullsisë); - të analizojë procesin e migrimit si promotorin e të gjitha ndryshimeve demografike të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në periudhën pas vitit 1990; - të evidentojë territoret ku kanë migruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integrimit të tyre; - të analizojë ecurinë e zhvillimit të popullsisë dhe vendbanimeve në trevat shqiptare, përmes treguesve statistikorë, grafikë etj.;
Ekonomia e trevave shqiptare	<ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë potencialet natyrore dhe humane të trevave shqiptare dhe ndikimin e tyre në shkallën e zhvillimit ekonomik të këtyre trevave; - të analizojë rolin e sektorëve të veçantë të ekonomisë në zhvillimin e trevave shqiptare (ekonominë bujqësore, industrinë, tregtinë, transportin, turizmin, shërbimet dhe artizanatin).

Linja: Ndërveprimi njeri - mjedis

Në këtë linjë prezantohen vlerat unike natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare, analizohet ndikimi i shoqërisë njerëzore në cilësinë e mjedisve gjeografike dhe shfrytëzimin e resurseve. Nxënësit aftësohen të identifikojnë strategjitë alternative që u përgjigjen politikave të veçanta dhe programeve për përdorimin e burimeve dhe menaxhimin e tyre. Ata

jo vetëm që njohin dhe evidentojnë potencialet turistike të trevave shqiptare, por edhe parashikojnë mundësitë e mirëmenaxhimit të tyre.

Bloku tematik	Objektivat
Mjedisi dhe turizmi i trevave shqiptare	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë vlerat unike natyrore dhe historiko-kulturore të trevave shqiptare; - të evidentojë potencialet turistike dhe zonat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit; - të identifikojë faktorët dhe pasojat e problemeve mjedisore kryesore sot (ndotja e ajrit, ujit, tokës).

Linja: Rajonet

Në këtë linjë, nxënës/i,-ja analizon dhe vlerëson për çdo rajon tiparet specifike natyrore, demografike, kulturore, ekonomike, duke i vendosur kështu në plan krahasues me njëri – tjetrin. Në këtë mënyrë, ai/ajo do të kuptojë ndikimin e veçorive fizike dhe humane në proceset, fizionominë e rajoneve dhe nënrajoneve të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare.

Linja “Rajonet” përbëhet nga blloqet tematike:

- Rajonet gjeografike të trevave shqiptare.
- Republika e Shqipërisë
- Rajoni Perëndimor.
- Rajoni Verior dhe Verilindor.
- Rajoni Juglindor.
- Rajoni Jugor.
- Republika e Kosovës.
- Trevat shqiptare në Serbi.
- Trevat shqiptare në Maqedoninë Perëndimore.
- Trevat shqiptare në Mal të Zi.
- Trevat shqiptare në Greqi.

Bloku tematik	Objektivat
----------------------	-------------------

Rajonet gjeografike të trevave shqiptare	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- të identifikojë kriteret e përcaktimit të rajoneve gjeografike të trevave shqiptare, ndarjen rajonale të trevave shqiptare dhe tipat e rajoneve.
Republika e Shqipërisë	<ul style="list-style-type: none">- të analizojë tiparet specifike natyrore, demografike dhe ekonomike që dallojnë Republikën e Shqipërisë nga trevat e tjera shqiptare dhe faktorët e diferencimit të saj rajonal; rajonet gjeografike;- të vlerësojë akset dhe drejtimet e zhvillimit të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë me shanset dhe mundësitë që ofron ajo për integrim rajonal dhe evropian.
Rajoni Perëndimor Rajoni Verior dhe Verilindor Rajoni Juglindor Rajoni Jugor	<ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe ofertat potenciale natyrore për zhvillim;- të evidentojë karakteristikat kryesore të popullimit të këtij rajoni, me fokus të veçantë rritjen e shpejtë të popullsisë dhe ndryshimet strukturore të saj;- të analizojë urbanizimin e shpejtë të këtij rajoni dhe rrjedhojat e tij;- të vlerësojë shumëllojshmërinë e hapësirave të prodhimit bujqësor e industrial, sektorit terciar, rrjetin e transportit dhe rolin e tij në prirjen e organizmit të ri hapësinor të rajonit.- të përshkruajë mozaikun natyror të Rajonit Verior dhe Verilindor dhe ofertat potenciale natyrore për zhvillim;- të analizojë tendencën e ndryshimeve demografike të këtij rajoni me problematikat që e shoqërojnë;- të evidentojë tiparet kryesore të aktivitetit aktual ekonomik të kufizuar të këtij rajoni;- të analizojë veçoritë natyrore, demografike e ekonomike të Rajonit Juglindor;- të analizojë tiparet e përgjithshme natyrore dhe humane që dallojnë Rajonin Jugor;- të evidentojë pasuritë e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të këtij rajoni;

Republika e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë Republikën e Kosovës si një rajon gjeografik me kufi të qartë natyror dhe politik, veçori specifike fiziko-gjeografike, demografike dhe ekonomike; - të evidentojë diferencimin rajonal dhe tiparet gjeografike natyrore, demografike dhe ekonomike të Rajonit Perëndimor dhe Lindor të Kosovës;
Trevat shqiptare në Serbi	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë trevat shqiptare në Serbi (Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën), veçoritë specifike natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre;
Trevat shqiptare në Maqedoninë perëndimore	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë statusin politik të trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore me tiparet e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike, që i dallojnë ato nga trevat e tjera shqiptare;
Trevat shqiptare në Mal të Zi	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë rëndësinë e pozitës gjeografike dhe gjeopolitike të trevave shqiptare në Mal të Zi, veçoritë e tyre natyrore, demografike dhe ekonomike;
Trevat shqiptare në Greqi	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë kushtet specifike të trevave shqiptare në Greqi me vlerat e veçanta natyrore, demografike dhe ekonomike të tyre.

GJEOGRAFIA E PROBLEMEVE GLOBALE – Klasa XII

Linja: Sistemet humane

Kjo linjë zhvillon aftësitë e të menduarit kritik rreth ndërveprimit të sistemeve kulturore, ekonomike, politike, mjedisore, teknologjike dhe pasojave të tij në nivel global. Nxënësit përdorin perspektivën hapësinore për trajtimin e një sërë problemeve bashkëkohore, të tilla, si: rritja e popullsisë, urbanizimi me ritme marramendëse, shumëllojshmëria kulturore, degradimi mjedisor, globalizimi i ekonomisë etj.

Linja “Sistemet humane” përbëhet nga blloqet tematike:

- Dinamikat e problemeve të popullsisë.
- Ekonomia globale dhe problematikat shoqëruese të saj.
- Tiparet dhe problematikat e zhvillimit urban.
- Zhvillimet gjeopolitike të botës së sotme.
- Çështje sociale, problematikat dhe gjeografia e tyre.

Bloku tematik	Objektivat
Dinamikat e problemeve të popullsisë	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë tendencat (prirjet) e popullsisë botërore dhe modele të rritjes së ardhme rajonale; - të analizojë rritjen e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, faktorët që ndikojnë në këtë rritje dhe shpërndarjen e popullsisë; - të përshkruajë tiparet kryesore të qyteteve më të populluara sot në botë; - të analizojë ecurinë e të dhënave të mbledhura dhe të paraqitura grafikisht të disa modeleve tipike demografike botërore; - të përshkruajë stadet e migracionit të brendshëm nga zonat rurale drejt zonave urbane në rajone apo shtete të ndryshme të botës, shoqëruar me raste studimore; - të evidentojë strategjitë për uljen e migracionit nga zonat rurale drejt zonave urbane; - të analizojë shkaqet e migracionit të jashtëm dhe pasojat e tij përmes rasteve studimore nga vende të ndryshme; - të evidentojë disa ndër strategjitë për kontrollin e emigracionit, duke veçuar strategjitë e BE-së lidhur me këtë dukuri; - të analizojë shkaqet e emigracionit të jashtëm në Shqipëri pas viteve '90 dhe pasojat e tij; - të përcaktojë shpërndarjen hapësinore të gjuhëve më të përhapura sot në botë dhe rajonet gjuhësore, me veçoritë e tyre të zhvillimit; - të përshkruajë disa ndër politikat për mbijetesën e gjuhëve të minorancave; - të tregojë shpërndarjen hapësinore të problemeve etnike më të spikatura përmes rasteve studimore (si p.sh.,

	<p>problemet etnike në Ballkan; baskët në Spanjë; tibetianët; etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë shkaqet e konflikteve etnike dhe problemet që i shoqërojnë; - të vlerësojë politikat dhe perspektivat e zgjidhjes së konflikteve etnike; - të tregojë shpërndarjen hapësinore të besimeve fetare më të përhapura sot; - të analizojë disa ndër problematikat më të spikatura fetare (konflikte) dhe rajonet e tyre;
<p>Ekonomia globale dhe problematikat shoqëruese të saj</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë shpërndarjen e pabarabartë të të mirave materiale në shkallë botërore dhe rajonale; - të analizojë faktorët që ndikojnë në nivelin e zhvillimit ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, shoqëruar me shembuj; - të analizojë mobilitetin (lëvizshmërinë) e aktiviteteve të ekonomisë moderne sot, faktorët që ndikojnë, si dhe pasojat e kësaj lëvizshmërie; - të vlerësojë bashkëpunimet shumëkombëshe (si. p.sh., Toyota, General Electric etj.), si mjet suksesi në treg; - të përshkruajë veçoritë e revolucionit të gjelbër dhe pasojat e tij në zhvillimin e rajoneve ku është zhvilluar; - të identifikojë modelet e industrisë botërore dhe tendencat e zhvillimit të saj në ditët e sotme; - të përshkruajë pasojat e zhvillimeve industriale dhe revolucionin teknologjik (fazat, ndryshimet sot); - të analizojë zhvillimin e sektorit të shërbimeve sot në botë, tendencat e zhvillimit dhe shkaqet e zgjerimit të tij; - të rajonizojë shpërndarjen gjeografike të sektorit të shërbimeve sot në botë; - të analizojë natyrën globale të tregtisë (ndërvarësinë e ekonomisë botërore sot) dhe rëndësinë e këtij sektori shoqëruar me studim rasti;

	<ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë peshën që zënë në tregtinë globale, produkte si: nafta, hekuri, gruri, makinat etj.; - të interpretojë rolin e organizmave ndërkombëtarë, si OBT, BE, G8, NAFTA, OPEC dhe politikat e tyre në tregtinë botërore; - të identifikojë karakteristikat e zhvillimit të rrjetit botëror të transporteve sot, shoqëruar me shembuj; - të përshkruajë zhvillimin e telekomunikacionit sot dhe tiparet e zhvillimit, shoqëruar me shembuj; - të analizojë shkaqet, pasojat dhe veçoritë e zhvillimit të krizës ekonomike globale në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim;
<p>Tiparet dhe problematikat e zhvillimit urban</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë karakteristikat e qendrave urbane dhe atyre rurale dhe tendencën e rritjes së shkallës së urbanizimit sot në botë; - të përshkruajë veçoritë e funksionimit dhe të zhvillimit të megaqyteteve në botë; - të krahasojë, përmes shembujve, modele të ndarjes administrative dhe të decentralizimit të qeverisjes; - të përshkruajë veçoritë e ndarjes administrative në Shqipëri dhe problemet që janë evidentuar;
<p>Zhvillimet gjeopolitike të botës së sotme</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë ndryshimet e hartës politike të botës (dekolonizimin) deri në Luftën e Dytë Botërore dhe evolucionin e saj pas Luftës së Dytë Botërore; - të analizojë krijimin e shteteve të reja pas rënies së murit të Berlinit (kushtet, faktorët), problematikat që kanë shoqëruar zhvillimin e tyre, shoqëruar me shembuj; - të përshkruajë polet e fuqive të mëdha, kushtet të cilat i favorizojnë këto vende për të qenë të tilla; - të përshkruajë raportet që kanë vendet pole me vendet e tjera.

<p>Çështje sociale, problematikat dhe gjeografia e tyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë faktorët që ndikojnë në shpërndarjen gjeografike të varfërisë (të ndalet në faktorët humanë); - të vlerësojë perspektivën e kësaj problematike; - të analizojë problematikat që shoqërojnë trafikun global të drogës (vendet importuese dhe eksportuesit më të mëdhenj); - të përshkruajë perspektivën dhe strategjitë për zgjidhjen e kësaj problematike; - të analizojë faktorët që nxisin tregtinë dhe trafikun e armëve, korridoret e trafikimit, konfliktet rajonale, shoqëruar me shembuj; - të identifikojë vendet që konsiderohen si fuqi bërthamore botërore, shoqëruar me shembuj të specifikave të tyre; - të vlerësojë politikat botërore për parandalimin e prodhimit të armëve bërthamore.
--	---

Linja: Ndërveprimi njeri - mjedis

Përmes kësaj linje, nxënës/i,-ja kupton pasojat e ndërveprimeve midis sistemeve fizike dhe humane, diskuton pro dhe kundër politikave të veçanta dhe programeve për përdorimin e burimeve dhe menaxhimin e tyre.

<p>Bloku tematik</p>	<p>Objektivat</p>
<p>Sfidat e mëdha të shekullit XXI</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë shpërndarjen gjeografike të burimeve të energjisë në botë; - të përshkruajë përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë sot në botë (energjinë e erës, diellit, ujit, biomasën, energjinë atomike), shoqëruar me shembuj, duke veçuar vendet tipike të shfrytëzimit të secilës; - të analizojë shkaqet dhe pasojat e ngrohjes globale; - të vlerësojë politikat botërore e rajonale për ngrohjen globale; - të analizojë rajonet më të ndotura sot në botë, shkaqet dhe

	<p>pasojat e tyre në zhvillimin rajonal e botëror;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë faktorët që ndikojnë në prishjen e ekuilibrit në ekosisteme të rëndësishme (p.sh., shpyllëzimet në Indonezi, në pellgun e Amazonës etj.), si dhe pasojat për mjedisin; - të vlerësojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes koordinimit të politikave rajonale me ato globale të zhvillimit; - të identifikojë rrugë dhe strategji drejt një zhvillimi të qëndrueshëm industrial, bujqësor dhe urban.
--	---

3. SHPËRNDARJA E PESHAVE SIPAS FUSHAVE

1.	Shkenca e Tokës	25%
2.	Gjeografia rajonale e botës	15%
3.	Gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare	30%
4.	Gjeografia e problemeve globale	30%
	TOTALI	100%

4. SHPËRNDARJA E PESHAVE SIPAS LINJAVE

Nr.	Linja	Ndarja e peshave në përqindje
Shkenca e Tokës		
1.	Sistemi diellor	3%
2.	Hartografia	2%
3.	Gjeosistemet	12%
4.	Dinamika e Tokës	6%
5.	Mjedisi dhe shoqëria	2%
Gjeografia rajonale e botës		
6.	Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve	4%
7.	Rajonet	11%

Gjeografia e Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare		
8.	Vendndodhja gjeografike	1%
9.	Sistemet fizike	4%
10.	Sistemet humane	7%
11.	Ndërveprimi njeri-mjedis	1%
12.	Rajonet	17%
Gjeografia e problemeve globale		
	Sistemet humane	24%
	Ndërveprimi njeri-mjedis	6%
TOTALI		100%